

BIBLIOTEKA
SHETER

828-1

721

SOLE JAKOVA

HEROJT E VIGUT

Poemë

7-1
24
KOLË JAKOVA

[Handwritten signature]

HEROJT E VIGUT

(Poemë)

BOTIM I GJASHTË



SHËTËPIA BOTËONJESE «NAIM FRASHËRI»

4
H

I

Ngjitet Velës varg përperjetë
çeta e vogël me pes' vetë;
gjith' petrira djem të letë;
djem të letë, djem të ri,
Ndoc Ded Marku u ka pri;
shtatin gjat' porsi selvi
synin pish', turrin duhi.
S'e lodh buka as s'e lodh moti,
zemra e ti fuçi baroti,
djat ma trim nuk ka Miloti.

Parzmin jasht' e kryet zbulue,
nën dor' pushkën n'zjarr gatue,
bombat var' i rrijn' kërcnue
n'rryp të gjan' për brez shtrëngue;
krahaqaf' prap një rryp tjetër,
varg fishek't si dhamb' kulçedre,
kalon shtigje plot rreziqe,
malit t'Velës brigje brigje
na i bie Ndoci e an' për anë,
vrinë e skut' me sy i përulanë.

Djal i zoti Ahmet Haxhia
si zamak për kah hjeshtia,
syni i tij flakë e shkëndija,
shkollë e luft' ja msoi Partia.

Djal

Djal i gojës, djal me kokë,
fjala e tij nuk bie n'tokë.

Kur ze Meti t'kuvendojë,
s'ka fshatar, që mos t'a dojë,
fjala mjaltë i rrjedh për gojë;
fjala mjalt' zemra barot,
çka thotë aj, topi s'e lot.

Por nuk ka veç vetëm fjalë
Met Haxhia, sokol djalë;
kur asht puna me qindrue,
me i dal' m'anë o me mbarue,
idhtas Meti ather' sulmon,
kudo kris e bumbullon,
pushkë as top ma s'e ndalon.

Hydajeti djal leshjanë,
rrit' jetim pa bab' pa nanë,
strehve t'hueja flej pa ngranë,
mori malin për të letë
babë e nanë i gjeti n'çetë,
vlla e motër nga çdo anë
gjet ndër shokët partizanë.

Naim Gjylbegu e Ndoci i vogël
lind e rrit' të dy në Shkodër,
Ndoci i vogël fukara
rrit' me zor nëpër dynja.
Kur na duel Partia n'dritë
sa shpejt djemve u hapi sytë,
i than' Shkodrës: «lamtumirë!,
veç kur t'shifna n'Shqipni t'libër!»

Ngjitet Velës varg përpjetë
çeta e vogël me pes' vetë

gjith petrita djem të letë.

— Kah po shkoni o partizanë?

— Duem me i dalë Mirditës mb'anë
shpi për shpi e stan për stan,
sihariqin me ia çue:
madh e i vogël m'u shtërngue,
flak' për flakë m'u djeg' n'gjerman,
s'ka ma dreq as kapidan,
që e ndal' turrin partizan.

«Sihariq, o moj Mirditë!
po na vjen e bardha ditë
ndër Ballkane kanë arritë,
kanë arrit' bijt e Leninit,
që i bijn paqën rruzullimit.

Ky ushtari sovjetik,
mbrujtun zemrën me çelk,
lufton natë e lufton ditë,
botën mbarë e ka çuditë,
kah i dërmon e i ndjek' si dhitë
urdi-zezat e Hitlerit,
tkurrë e ba dyfish prej tmerit
dhe u jep popujve liri,
siç po ngjan tek ne n'Shqipni.

Dredh gjermani mbush' me mni,
digj e vra e kap ku t'kapin,
don me dal' pa e la hesapin.

Por ushtria çlirimtare
lyp' hesap deri n'nji pare,
se s'jem' shpi e dalun fare,
as nuk jem' stan me bagti,
me na pre fashisti i zi,

3

4

5

por jem' trima xhet me xhet,
mjer kush vendin ne na nget,
se bash gjarpni ate e përket.

Ktu e pagoi turku dikur
porsi ai ujku me lëkurë,
jo ma sot që kem' Partinë,
n'ball të luftës kah na prinë.

Le ta thot' fashist taljani,
që 'i dekik rahat s'e bani,
zmbrapu natë e zmbrapu ditë,
hik prej pritët e bie n'pritë,
flak' iu dogj dheu për nën kambë,
der sa i erdh shpirti ndër dhambë,
e nji ditë çoi duert përpjetë,
dorzoi armët për ibret.

S'del kollaj pra kndej gjermani,
për pa e la gjakun që bani,
s'del kollaj as kapidani,
kapidani me gjith' shokë,
për pa la hesap me kokë.

N'kamb' sokolat e Mirditës!
djemt e Fandit e t'Selitës,
ju gomsicash, bushkashjanë,
n'at' Orosh pritën t'ua zamë,
nji për be me dal' mos t'lamë,
as gjerman, as kapidan,
ju prijn' shqipet partizan'!»

Kalon Velën për të letë
çeta e vogël me pes' vetë,
fill kah Vigu jan' drejtue
shok't e vet për me i takue.

Dielli i verës se ç'po i djeg,
hjeksi i Gjonit fort po i ndjek,
hap për hap e shtek për shtek.

II

Markagjoni n'at Orosh,
— Aman zot të ndah'na shndosh —
S'e ze gjumi natë as ditë,
Ishon kushtrimin nëpër Mirditë,
na ka mbledh' bashibuzukë,
ca katila e ca hajdutë;
me nazista lyp' derman,
me gjerman' lhan' n'nji kazan.

— Hajde, hajde or kapidan!
se ka burra sot Mirdita
djem të let' porsi petrita,
që kan' marr' malin përperjetë,
n'shkamb të that' i kan' foletë;
fort po i don ky pop'lli i vet:

Bardhok Biba e Ndrec Ndue Gjoka,
djem ma t'mir' nuk i mban' toka.
Bardhok Biba ka shum' shokë,
që t'i bajn' sarajet trokë.
Bardhok Biba ka Partinë
E Partia mbar' Shqipninë;
çliruen Matin e po vijnë,
del n'çardak vene dylbinë,
n'at' Bushkash shiko ushtrinë
Vlojn' brigadat porsi bletë,
kah po i shkojn' malit përperjetë

partizan' sokol me fletë.

Ku po shkojnë, o kapidan?
thon' se lypin strofflin tand,
se sarajet t'i kërkojnë,
t'i përmbysin, t'i sheshojnë;
hie t'zez' bajn' mbi Mirditë,
bar e gjeth nuk lan' m'u rritë. —

Por pa e bam' edhe 'i gjak tjetër
s'don me ngordh' ky ujku i vjetër.

Pjetër Lleshi, qen zagare,
nanë e babë e shet për pare,
ndër hajdut' si kumandar
kapidani e ka vu t'par'.

Ndër hajdut' bashibuzukë
ka vu pritë e na rri strukë;
kudo lajmin po ja ep
pritës s'Vigut shkrep për shkrep.

Hjeksi i Gjonit fjal' na bjen:

«— Ndoc Ded' Marku po na vjen,
n'dalme t'Vigut për mb'atë anë,
vetë i pesti partizanë.

Kërkund shtegun mos t'ja lamë,
mos t'i vrasim por t'i zamë;
t'i turpnojm' nëpër Mirditë,
lidhun varg porsi bagtitë.

Erz e nder t'ua marrim fare,
mos t'u baj' ma lkura 'i pare.

Do t'i varim n'pik' të ditës,
t'i hyj tmera gjith' Mirditës,
t'i shof' plak e kalama,
kuj ndër mend mos t'i bie ma

me sha Gjonin për tradhti,
tue kundue kang' me qifteli,
tue marr malin, tue kalue
me Bardhokun tu' u bashkue.

7

Kapidani ka premtue:
urdhni n'vend mbasi t'jet' çue,
qofshi lir', qofshi bekue,
bini pre ku doni vetë,
ku ma e majme preja t'jetë,
ku ma e majme, ku ma e letë,
bini plaçk', merrni bagti,
n'arka' grash paj' e stoli,
n'hise s'due ksaj' her' m'u hi.—»

8

III

Ushton Vigu, gur e zall,
s'lidhen burrat për të gjallë,
s'lidhet Ndoci me gjithë shokë,
për pa i shkue gjaku për tokë,
për pa vdek' për pa mbarue,
n'vend Partis' fjalën m'ja çue.

Ta marr' vesh Mirdita mbarë,
Markagjon e kumandarë,
se luftarët e lirisë,
lidh për fjalën e Partisë,
s'i tremb pushka e tradhtisë,
s'i tremb pushka as s'i tremb deka,
plumbja ata kur po i preka,
nëpër mish e gjak s'po veka

9

porse 'i depo plot po haska
shumë barot mbrend ajo paska,
vaj medet aty ku plaska.

N'dalme t'Vigut bri nji sheshi
i bzan çetës Pjetër Lleshi:

— Ndali, djem — o, kah po shkoni!
ka urdhnue kapidan Gjoni,
njato armë a po i dorzoni? —

Fjala mir' për pa mbarue,
fill për tok' çeta u rrzue,
gati arm't me ja fillue.

Ky Ndoc Deda djali s'quet
shikon vendin skut' për skutë,
mir' po e din se ku asht futë,
mir' po e shef se për gjithë anë
prita çetën e përlanë.

Shpejt ka brofun Ndoci n'kambë
pushkën ngref', bombën ndër dhambë.

Shok't e vet i ka shikue
t'gjith në kamb' për dek' gatue:

— Lejën shok' due me ma dhanë,

dy fjal' pritës me ja thanë

e mandej të vdesim tanë,

si (â) zakoni n'partizanë!

— Fol, o Ndoc, folë nji fjalë,

bombë fjala goje t'dalë!

— Qite kryet, or kapidan,

— thirri Ndoci, — në ta mban!

se dy fjalë due me t'i thanë:

«Këto arm', që kem' shtrengue,
s'i kem' marr' për me i dorzue,

n'zakon tand nuk jemi msue,
se s'jem cuba, shokët tu.

Partizan' emnin na thonë
edhe luft'n e kem' zakon!

Vendit ton' na i dalim zot
n'mos na njofke, njifna sot!

Pa ndigjo, more plaçkitës,
s'shitet populli i Mirditës,
s'shitet populli shqiptar
posi ai demi në pazar!

Shitet Pjetri e Gjon Dodani,
Markagjoni — kapidani,
te taljani e te gjermani!

Por kadal, o ujku plak,
se ta lajm' trupin me gjak
ta qindisim për marak
për tradhtar' plumbja asht hak!

Le ta dij e zeza pritë,
le ta dij kush s'e ka dijtë,
se n'gjerman' Gjoni u ka shitë!

Le t'kuptojë kush t'kuptojë
t'dahet anësh e t'kalojë,
gjakun ton' mos ta kërkojë
se asht helm që do e tërbojë!

Le të qesë kush të qesë,
deri n'dek' besnik t'i mbesë
Markagjonit e gjermanit,
t'ia njof' turrin partizanit.

Krisja pra, or kapidan,
ktu na ke, jemi n' mejdan,
ku vdes burri për vatan!>

Po ç'ka prita që s'po qet?
çka ka ndodhun, o medet?

Ç 'ka ka ndodhë e çka s'ka ndodhë,
Pjetër Lleshi i gjatë e i hollë
po përdridhet porsi bollë,
po përdridhet e bërtet,
ushton zani n'rrahe shkret:

— Kthehi, qena, ku po shkoni,
kush ju tha pritën ta lshoni?

— Për at qiell e për at gur,
(ja kthen dal' një m'rdituer,
marr, me zor porsi shumë tjerë.)
s'po shti m'ta sot për pa m'therë!

«Pa ndigjo, more, ti Pjetër,
(i përgjigjet prap një tjetër,)
ti na ke hesap të vjetër
në Mirditë e n'partizan,
prandej krisja në ta mban!

→ Krisja ti me shokët tu,
se kta djem që ke rrethue
do ta bajn' vorrin një ditë
e le nam nëpër Mirditë!»

Ka nis' prita m'u përzi,
dikush shti dikush nuk shti.

Ky Naimi tu' u afrue
pritës mbar zan' ja ka lshue:

«Hapni syt mos m'u tradhtue,
se n'lak Pjetri don m'u zanë
n'gjak m'u qit' me partizanë;
me ju ba hise nt'radhti,
kur t'i vi sahati i tij.»

Met Haxhia, shqipe e gjallë,
i del pritës ball' për ballë,
s'don me vdek' pa i fol' dy fjalë.

«O Mirditë, o gur, o mal,
katër shpi ju me një kalë;
tri pllam' tok' varun në bri,
tre muej buk' ma e mira shpi.

Shif sarajet n'at Orosh.
Markagjon ti mos i gzosh,
se i ka ngrit' gjaku i vegjlisë,
gjaku e lodja e gjith' malsisë.

Se i ke ngrit' me gjak shqiptari
tue vra fitmesh e mbas gardhi,
tue lshue cuba për gjithë anë,
pre, plaçkit natën pa hanë.

10

Hyn një krajl e del një tjetër
e ven Gjoni gishtin n'letër
me ia fal' Shqipnën' Talisë,
Italisë e Gjermanisë
kujt ma mir' t'i leverdisë.

Por kadal', klysh i tradhtisë,
se s'ke lejen e Partisë!

S'asht Shqipnia si dikur:
Turk shyqyr — halldup, mehmur,
Ahmet Zog e Lala Kros
Mit'hat Beg e Hasan Dos!

—> Pop'lli e vendi sot kanë zot,
partizan' mbush' malet plot,
t'japim plumb, t'japim barot!>

/ Kështu foli Met Haxhia, >

e dëgjoji e gjith' pusia
e prap nisi atje me vlue;
nuk don prita me luftue.

Tek sarajet, gur latue,
fjala Gjonit i ka shkue,
ka nis bisha m'u tërbue,
ulurin porsi kulçedër:

«Gjall' o vdek' i due pa tjetër!»

IV

Penenotesi

Gur e shkropa se ç'ushtojnë, *metafora*
ç'jan' kta krushq, që po këndojnë?
sa mir' kangës po ia thojnë,
kë vallë sot ata martojnë? *pyetje retorike*

Edhe Gjadri i tërbue
po gjimon tue gurgullue,
zhurm' e kang' i ka bashkue.
Fort ta kanda me e ndigjue!

Le t'gjimojë sa të dojë,
Gjadri i zi kurr mos t'pushojë,
se s'asht dasëm as gosti,
atje n'Vig mbrenda n'pusi,
tue prit' vdekjen nga çdo anë,
këndojn' trimat partizanë.

S'duen ket' jetë ata me e lanë,
nji herë kangës pa ja thanë.

Ndoci i vogël flet nji fjalë:
«Të këndojm' dalë e ku t'dalë!
dit' e madhe na ka ardhë

sot m'u nda me faqe t'bardhë,
faqebardh' para Partisë,
para shpisë edhe Shqipnisë,
tue u vra me arm' në dorë,
m'u rrjeshtue ne me dëshmorë!

Nisja kangës Hydajet,
kndo Naim e kndo Ahmet,
le të vdesim me gajret,
si na msoj me vdek Perlati;
tym e flak' kur iu dogj shtati;
dridhi mal e dridhi kodër
e la nam mbrenda në Shkodër!

Çeta e vogël po këndon,
gjith pusia e dëgjon,
e dëgjon e ban çudi:

a jan' njerz a jan' xhindi?!
çka do t'jet' kjo farë e re,
që s'e tremb vdekja n'kët fe?

Nuk jan' xhindi, o kapidan,
por jan' trimat partizanë,
jan' evladi i Partisë,
drit' e shpres, e Shqipënisë.

Sapo kanga ka mbarue,
Ndoci i vogël n'kamb' u çue,
shikon malet an' për anë
nji amanet don me ua lanë:

«Amanet, o more male,
kur ushtria ktu të dalë,
shokve ton' ju me m'iu falë,
me u tregue si kem' luftue,
si jem' vra, si jem' coptue,
rreth e rreth prit' ngujue.

Andri Kuci
Lamtumir' nana Parti,
jetën ton' ta falim ty!

Kem' punue si na ke thanë
e gja mangut s'kemi lanë,
deri ktu kem' ardh' me nder,
kshtu po ndahna edhe ksaj herë.

Po na vret plumbja e tradhtisë
për hesap të Gjermanisë,
porse plumbja s'na tremb ne,
se na ushqeve me ide t're,
ide t'Marksit e t'Leninit,
që â shpëtimi i gjith njerzimit!

Lamtumir' për t'fundit herë
edhe n'vorr ta dijm' për nder!

Lamtumirë, o moj Mirditë,
gjaku jon' t'u bafhtë dritë,
na ke pritë e na ke qitë,
bukën para na ke shtruve,
bukë e kryp' çka ka qillue,
na ke la na ke arnue,
kmishat tona laskarue!

Prej rreziqesh na ke rujtë,
ke ndihmue sa ku ke mujtë!

Keq për ne pra mos t'ju vije,
se kshtu burrave u ka hije:
fjala e folme në kuvend,
la me gjak ma mir' ze vend!

Lamtumir' shok't e Partisë,
shok't e luftës e t'rinisë;
lamtumirë i bajmë shtëpisë,
nanë e motër, babë e vlla,

amanet: mos me na qa,
se n'Mirdit' ne kemi ra!»

V

N'tdalmet t'Vigut, n'rrahe t'shkret'
tmershëm bombja po pëlçet,
valon pushka për gjith' anë
qpo luftojn' pes' partizanë!
dyqind vetë i kan' rrethue,
s'vdesin burrat pa u pague!

Mbas një bingu atje në breg

12

Ndoc Ded' Marku rrall po qet,

s'e lan plagët me shpejtue,

s'e len gjaku me synue,

Njiqind tyta po e qëllojnë,

varrt' ma egër ja acarojnë,

acarohet Ndoci vetë,

zjarr i ndizet zemra e shkretë,

bungun len e pritës n'ball

sulmon trimi n'fush të gjallë,

dy granata mbrend' ua kallë,

dridhen malet, shungullojnë.

gryka e shtigje bulurojnë.

s'e njëf prita ma shoshojnë;

shum lan' shkepat e kalojnë.

Hydajet, o Hydajet,

pushka jote drejt po qet!

«— Qilloi vendi rrahë-shkret,

pa një stom e pa një shkrep,

kurrë nuk binja. kaqë shpejt»

13

14

BIBLIOTEKA E SHKRETIT
GJITHSHTETI
17
12729

Met Haxhia po sulmon,
e merr plumbja e nuk ndalon,
bie përdhe, pushkën s'e lshon
edhe vdek' me shti kërkon.

«— Bini shok, e merrni hak,
(thrret Ndoc Mazi la me gjak,)
S'mundem ma me ju ndihmue,
katër plumba m'kan' përshkue,
bukur shtin' qenat mbi mue!»

Ndoc Ded' Marku, rrxue për dhe,
mezi kokën po e ngre.

Shikon logun rretheqark
ra si burrat shokët varg.

Veç Naimi ka teprue;
plague randë e tue u rrxue,
po i afrohet pritës s'zezë
edhe i her' zjarin e ndez.

Ku i ka forcat i përmbledh,
nji granat mbrenda ua hjedh,
Shungllon Vigu gjam' e tym,
bie Naimi porsi trim,
Buzqesh Ndoci kah e shikon,
syt' i err e kryet e lshon,
Gjithnji Vigu shungullon,
burrat vdek', gjama vazhdon.

— Të lumt' dora, o Naim,
digje pritën, bane tym,
tym e flak' edhe trishtim!
Der' n'Orosh gjama t'i shkojë,
kapidanin ta lajmojë

se kjo gjam' nuk do t'pushojë
atje n'Vig te e zeza pritë,
por do t'rritet natë e ditë
dhe mbi të do, shkrep rrufe
tu' e përmbys' me gur' e dhe
me nazista e me tradhtarë,
s'duron ma poplli shqiptar!

Mjaft u rop e mjaft u gri,
n'vend të vet pa plang pa shpi,
zgjedhn' e vet për fyt shtërngue,
kryet përpjet' pa mujt' me e çue,
bukën that' me lot rigue. 16

Po qan foshnja tu' u përtypë,
nuk po i shkon buka me krypë,
çveshë e z bathë e mbetë picak, 17
zemra e nanës pikon gjak;
pika e gjakut ndezet flakë,
ndezet flak' që përvëlton
prang' e zgjedh' sot po i copton.

VI

Baba i Ndocit del në derë:

«— Ç'asht kjo zhurmë e kjo poterë,
farë e fis ku jan' drejtue,
ditë e madhe s'ka qillue?»

— S'ka qillue, o medet...

Qindro, Dedë e ban gajret...

se na gjuejt moti rufe,
e rrxoi Ndocin dek' për dhe.

Atje n'Vig, atje n'Mirditë,
na u vra Ndoci ngujue n'pritë,
shtat sahat me shok' rrethue,
bukur trimat kan' qindrue,
zbardhën faqen e Partisë
nam' e nder i lan' Shqipnisë.

18

Baba i Ndocit thot' një fjalë:
«— Gjini i nan's i qoft' hallallë,
m'paska le për s'dyti herë,
se m'ka vdek djali me nder!

Por ç'e do, medet për mue,
kjo pleqnia, qoft' mallkue,
kamb' e dor' m'i ka ligshue,
s'e marr dot malin përpjetë,
m'u bashkue me shok' në çetë!

Rob't e shpis', mos u hutoni,
drek't e Ndocit por gatoni,
Gjith si burra të qindroni!

Ktu n'Milot ndër hund' t' gjermanit,
mbush' katila t'Bazit Canit,
t'ja bajm gjamën Partizanit.

S'kemi mort, për kemi gzim,
na u vra Ndoci n'luft' si trim,
le t'ja bajm' gjamën kushtrim!

Eni shokë, e kushrini,
hiç për mue keq mos t'ju vij,
se s'kam ngel' babë i pa djalë,
tre të tjer' i nxora n'mal,
gjith Partisë i qofshin falë!»

Kështu Deda foli n'derë,
nuk i luejti ftyra 'i herë,
nuk u prish, nuk u ngatru
e, si miq't i pat rrjeshtue,
urdhnoi gjamën me e fillue.
Ushton gjama nalt në shpat,
derdhet rranzës deri n'Mat,
bregut t'lumit mbi fushore,
vajton grueja mirditore:

«— (More Ndoc more zamak,
kush ta lau trupin me gjak,
pa ja pasun borxh' as hak.

— Nuk më vrau borxh i shtëpisë,
por m'ka vra pushka e tradhtisë,
sepse i dola zot Shqipnisë.

— Fol, Ndoc, pse rrin largue,
n'Vig të that' në grop' mbulue,
nanë e bab' ku t'kan' gandue,
që s'po don sot me i takue,
pra burrnisht jan' tue qindrue,

— Nanë e bab' s'i marr mëni,
por ju la një porosi:

mos harroni shok't e mi,
Hydajetin e Naimin,

at Ndoc Mazin, Ahmet trimin,
gjith' njisoj ne me na qa,
kemi shkue si vllau me vlla,
dora dora jemi vra.

— Ti, o nana e Met Haxhisë,
lum për djal' që i dhe Partisë,
kishte qen' rrufe mizore

thue kish le me arm' në dorë;
fukaras me i dalun zot,
u përmend't për jetë e mot!
Pa ndigjo, nanë e Naimit,
hiqu gjamet e vajtimit,
s'i ka hije vaji trimit.
Bane zemrën shkamb e gur,
se ato plag' që djali muer,
flak' jan' ndezun' e bajn dritë,
an' për an' nëpër Mirditë!>

Kshtu vajton grueja e Mirditës
n'at Milot në pik' të ditës,
s'mbeti kush pa e ndigjue;
zyb't e Bazit jan' tërbue: 19
grumbullohen me shoshojnë,
diçka shajn', diçka tërflojnë. 20
s'ua mban gjamën ta ndalojnë,
njatje von' n'oborr i shkojnë.

Po del Deda për m'u falë:
«— Pa ndigjo, ti Ded nji fjalë,
ta kërkon Bazi nji djalë
atje n'Luz nesër t'i dalë.

Po s'i doli, dijë mirë.
lkura jote shitet lirë,
shum ma lir' se Ndoci yt.
shpia djegë e laku n'fytyrë.
Nuk i thon' këtu Mirditë,
me ba gjam' e me bërtitë,
me sha Baz me sha gjerman,
thue se jem' ndër partizan.

df

S'e njef Bazin, more mik,
që me qen' mbërthye n'çelik,
ta merr shpirtin për dekik.»
«— Amanet ju mos m'u ngutë,
(ja nis' Deda urtë e butë)
Se nji dek' më ka qillue,
më ka lodh', m'ka turbullue,
drue s'po din gjegje m'u dhanë
baba i Ndocit partizan:

Abaz Agës çoni fjalë,
n'çetën tande paç' me dalë
nja dy plumba me t'i falë,
por jam plakë e jam zhgatrrue,
udh't e gjata s'jan' për mue.

Por po deshe m'u përpjekë,
për me m'vra e për me m'djegë
hajde, bujrum, në Milot,
kulla ime vendit s'lot,
ta shtroj sofrën me barot.—»

VII

Hiku nata mbi Mirditë,
dielli majave po ndrit,
fillon qiellit me iu njitë;
zbulojn' malet shoqi shojnë,
zgjohen pyjet e shëndojnë,
zogjt ndër lisa po këndojnë.
Lum e lum kjo dit' e re,
çka po siell këtu ndër ne,
që gëzon sot gur e dhe. *Am.*

E ndigjon një za burie,
n'ato pllaje, n'ato hije
se sa bukur sot po bie,
Edhe grykat po ushtojnë
me jehon' kah po lodrojnë?

Tri brigada grumbullue
në Perlat të gjith' rrjeshtue,
rrin' gatitu shtang' në kambë,
armatos' deri ndër dhambë,

Enver Hoxha fjalë ka çue:

«— Ato male me i çlirue,
kamb' nazisti andej mos dalë,
kamb' nazisti e kamb' tradhtari,
n'mal e gur t'u bahet varri,
ta provoj' klysh' i tradhtisë,
si t'përdredh grusht' i vegjlisë. *medonini*

Sulm, pra maleve përpjetë,
krah për krah me pop'llin vetë,
që lufton, ka disa vjet
e krahëhapun po ju pret.»

Urra! thrret e gjith' ushtria.
n'sulm, o shokë! buçet buria.

• Msyjn' sokolat valë-valë
në Gëziq e në Shënpal
po rreh topi edhe mortaja,
bulurojn' malet e mdhaja.

Ndër llogoret e gjermanit
pëlçet bomba e partizanit,
shpërndan vdekje plot me tmer,
fluturojn' kaptinat n'erë,
heshtin tanke e heshtin topa,
byth-përpjet', palmuç ndër gropa.

N'at' Orosh u dha kushtrimi,
kullës s'Gjonit po i del tymi.

Gra e fmi nëpër Mirditë,
po rrijn' tymin tue soditë,
zemra u kndon, fytyra u ndrit.

Markagjoni, kapidani,
rrethue topa, ushtar' gjermani,
tri or' luft' lëkura i bani.

Baba i Ndocit edhe 'i herë,
ndigjon zhurm', ndigjon poterë,
mbajt' për shkop, po del në derë.

Me dor' diellin kah po e pret
larg shikimin e humbet,
kulla e Gjonit tym po qet.

Zemrën flak', synin shtangue.
tinës lodja tue e tradhtue,
nis ngadal' me murmurue:
«— Partizanve lavd e nder
ke po m'ngjallin dhe një herë,
ke po m'ngjallin e m'përtrijnë,
po ma kthejn' prap sot rininë
nëpër dej e nëpër gjak,
Ded Markola s'asht ma plak.»

Dalngadal' tue u zemrue
flaku shkopin, u drejtue:

«— S'ka pleqni, që m'ndalon mue,
krah me djemt due me luftue.

Sillma pushkën, o baxhi,
mermi bombat në franxhi;
u ngjall N'loci e shok't e ti,
ranë pes', lindën njimi. —>

Sulmojn' trimat partizanë,
kurrkund shtegun nuk ja lanë,
gjallë o dek' për pa i zanë.
Ndiqi n'krep ndiqi n'bregore,
shtek pa shtek nëpër tërthore.
An' për an' nëpër Mirditë;
Ik' anmiku porsi dhitë,
tek çdo gur po gjen' një pritë.

N'tdalme t'Vigut, bri një stomi,
pushim bani bataljoni.

Te muranat varg rrjeshtue, 23
partizanët grumbullue,
për nder armët i drejtojnë,
shokt e luftës i kujtojnë.

Baba i Ndocit ec' ngadalë,
me të birin don m'u falë,
s'don m'u fal' si babë e djalë,
por si trima e luftarë.

Para vorrit po rri shtangë,
shikon gurt mbledhun muranë,
shikon trimat partizanë.

Buza i dridhet, zemra i vlon
Ndocin gjall po e kujton:

E pat dashun përmbi tjerë,
se s'ja prishi kurrnjisherë,
djalë i zoti, bulk me vlerë,

Sa her' plaka pat mendue
me 'i thëllanzë — o me u martue,
me 'i thëllanzë atje në fshat,
lule mali rrit' në fllad!

Kto mendime kah i kalojnë

plag'n e zemrës ja lëndojnë,
por nji her' s'e turbullojnë.

Ato vorre kah shikon
porsi shkambi n'mal qëndron:
«— Çou, o Ndoc — thot' — nuk ka hije
para burrash me ndej' shtri-e,
para burrash n'arm' shtrëngue,
që 'i mi lufta kan' kalue
dhe 'i mi lufta kan' fitue.

Çou Naim e çou Ahmet,
Ndoci i vogël, Hydajet,
shifni ushtrin' që po ju pret!

Çohi, djem; falniu me ne.
na uroni dit'n e re;
sillni syt nëpër Mirditë
e shikoni grat' e fmijtë
si galdojn' — o në kët ditë;
dit' ma t'madhe kurr s'kan pritë.
Foli Deda e duel n'njen' anë;
shokët trima partizanë,
për nder armët i shtrëngojnë,
po përpiqen të qëndrojnë,
fjalt' e plakut kah i ndigjojnë...

24

Hesht' natyra dalngadalë,
veç nji flamur valë-valë
po rreh palën nganjherë
Përbri vorresh, ngritun n'erë.

«Herojt e Vigut»

Shpjegime fjalësh e shprehjesh.

1. Vela

Mali i Velës ose Velit afër Lezhës.

2. Për të letë

Për të lehtë d.m.th. fluturimthi.

3. Urdi zezat

Ordhit e mallkuara.

4. E dalun fare

Krejt e humbur, e prishur Fshatarë nga Gomsiqja dhe Bushkashi.

5. Gomsiqash, bushkashjanë.

Kallauzi, spiuni.

6. Hjeksi

Këngë të tilla epike populli ynë ka kënduar e këndon duke i shoqëruar edhe me vegla të thjeshta muzikore si lahuta a qiftelia.

7. Tue kndue kang' me qifteli

Kujtojmë me këtë rast këngët popullore me titull «Dëshmorët e Vigut», «Bardhok Biba» etj. Këtë radhë nuk kërkoj pjesë nga plaçka që do të bëni.

8. N'hise s'due ksaj her' m'u hi

I përgjigjet me një herë një fshatar nga Mirdita.

9. Ja kthen dal' nji mirdituer

Me fitme, me fitë, shpifje Ngushëllim

10. Fitmesh

11. Gajret

12. **Bungu** Një lloj dushku mjaft i gjatë
13. **Bulurojnë** Këtu me kuptim bëjnë zhurmë të fortë e të rëndë.
14. **Shoshojnë** Shoqi-shoqin
15. **Qilloj vendi rrahë-shkret.** për qëlloi. Rastisi që ishte vendi me kodra të xhveshura. —
16. **Me lot rigue** Stom = breg.
17. **Picak** Nga fjala rigë-a = vesë shiu, shi i hollë. Këtu ka kuptim njomur me lot.
18. **Ngujue** Lakuriq
19. **Zybt** Rrethuar Folja është ngujoj rrethoj, mbyll. Pësore = ngujohem.
20. **Tërfillojnë** Zybët, të këqinjte. Bazi është tradhëtari Abaz Kupi.
21. **Palmuç** Turfullojnë, çfryjnë me hundë.
22. **Baxhi-a Franxhi** Mbledhur lëmsh përdhe Amvisa e shtëpisë.
23. **Muranat** ose frengji, dritare e hollë shtëpie a kështjelle prej nga mund të gjuash me pushkë.
24. **Galdojnë** Muranë, quhet një grumbull gurësh që janë vendosur atje ku është vrarë një njeri. Gëzohen.

Redaktor: Dhimitër Fullani
Kopertina: Pandi Mele
Korektor letrar: Neka Turkeshi

Tirazhi: 10000 kopje Formati letrës 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp. N.I.SH. Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë 1966